



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2022:065301

Datë: 02.04.2024

Numri i dokumentit: 05532477

P.nr.122/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, duke vendosur në lëndën penale kundër të pandehurit G. I. nga fsh. G. e E.K.L., për shkak të veprës penale Mos raportim ose raportim i rremi i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare nga neni 430 par.1 të KPRK-së, të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.4211/2021, të datës 21.03.2024, duke vendosur lidhur me kërkesën e prokurorisë për dhënien e urdhrit ndëshkimor, jashtë seancës gjyqësore, me datën 02.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-së në Prishtinë, PP.II.nr.4211/2021, të datës 21.03.2024, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Kundër të pandehurit:

G. I., i lindur me ... në fshatin G. e E. K. L., ku edhe tani jeton, nga i ati Xh. dhe nëna M. e gjinisë S., ka të kryer Fakultetin Juridik, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal, Shqiptar, Shtetas e Republikës së Kosovës, më parë i padënuar, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R Ë

Sepse:

I pandehuri G. I. gjatë muajit Mars të vitit 2021 në cilësinë e zyrtarit të lartë publik, Sekretar në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit në UP "Hasan Prishtina" në Prishtinë, i njëjti edhe pse sipas ligjit ka qenë i detyruar të bëjë deklarimin e pasurisë, të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, për periudhën paraprake të vitit 2020, ashtu që i pandehuri nuk e ka bërë deklarimin e tillë brenda afatit për paraqitjen e deklaratës së tillë,-

-Me këtë i pandehuri G. I. ka kryer veprën penale Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare sipas nenit 430 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, në konform dispozitave të neneve, 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 dhe nenit 430 par.1 të KPRK-së, si dhe neneve 493, 495 si dhe nenit 364 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon me:

DËNIM ME GJOBË

Të pandehurit i shqipton dënim me gjobë në shumë prej **300.-€**, (treqindeuro), të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguaj, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë me dënim me burgim, konfrom nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€.

DETYROHET i pandehuri në emër të paushallit gjyqësor, kësaj gjykate t'ia paguaj shumën prej 20-€, për Fondin e Mbrojtjes së Viktimave të Krimit, shumën prej 20-€, këto në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj PP.II.nr.4211/2021, të datës 21.03.2024 e ka akuzuar të pandehurin G. I. nga fsh. G. e E. K.L., për shkak të veprës penale Mos raportim ose raportim i rrem i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare nga neni 430 par.1 të KPRK-së, si dhe në të njëjtën datë ka kërkuar që të pandehurit ti shqiptohet urdhër ndëshkimor-dënim me gjobë për veprën e lartcekur penale.

Gjykata duke analizuar aktakuzën, si dhe Aktvendimin për fillim të hetimeve Pp.nr.... dt.31.03.2022, kallëzimin penal me numër të protokollit ... i dates 23.08.2021, gjykata konstaton se ka prova të mjaftueshme në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtetë ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me dispozitën e nenit 493 të KPPK-së parashihet se “Për vepra penale e cila parashihet dënimi me gjobë ose burgim deri në 3 (tre) vite, për të cilat prokurori i shtetit është i informuar me provat e besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë në aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor, në të cilin të akuzuarit do ti shqiptoi dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor”.

Gjyqtari me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes konform nenit 493 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor ndaj të pandehurit nga arsyet se dënimi për veprën penale me të cilën ngarkohet i pandehuri parashihet dënim me gjobë apo me burgim deri në 3 (tri) vite andaj gjykata konform dispozitave të lartcekura vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor u bazua konform nenit 449 dhe neni 450 të KPPK-së ndërsa vendimi për kompenzimin e viktimave të krimit u mor në bazë të nenit 36 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore- juridike, u bazua konform nenit 462 të KPPK-së, pasi që nuk ka prova në shkresat e lëndës të cilat e vërtetojnë lartësinë e dëmit të shkaktuar, andaj nga këto arsye i dëmtuari u udhëzua që kërkesën pasurore-juridike ta realizoj në procedurë të rregullt.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN
P.nr.122/24, me datën 02.04.2024

G J Y Q T A R I
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë në kundërshtim në afat prej 8 (tetë) dite nga dita e marrjes së të njëjtit, kundërshtimi i drejtohet gjyqtarit individual të kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2022:065301
Datë: 02.04.2024
Numri i dokumentit: 05532477